



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 79 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Naim Sahitit për shkak të falsifikimit të bexhit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

VENDIM

- I. PZAP-i shpallet inkompetent për të vendosur në këtë çështjes juridike.
- II. Shkresat e lëndës ti dërgohen Prokurorisë Publike Kompetente në procedurë dhe vendosje të më tejshme.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.04.2012, nga subjekti politik LDK, dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se Naim Sahiti, anëtarë i PDK-së nga Pojata ka qenë i dënuar për shkak të manipulimeve si komisionar në Softaj i cili është dënuar me 6 muaj burg. Sipas parashtrësies të ankesës ky person me një bexh po sillet nëpër Qendrën e Votimit në Softaj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

PZAP- i nuk është kompetent për të vendosur në këtë çështje juridike.

Nga shkresat rrjedh se në këtë çështje ka elemente të veprës penale nga neni 332 i KPK-së dhe lidhur më këtë ka kompetencë për të vendosur Prokuroria Publike Kompetente.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 79 /2012 më datën 03.05.2012.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

